



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 23.4.2024

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen rishikim të vendimit të Kolegjit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019 dhe rigjykimin e çështjes gjyqësore, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 42, datë 18.7.2018

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 11.3.2024, si dhe parashtrimeve dhe qëndrimeve të mbajtura në seancën e datës 17.4.2024, në mënyrë të përmbledhur, parashtron sa në vijim:

Komisioneri Publik, duke pasur në konsideratë se vendimet dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, adreson detyrime për të gjitha pushtetet shtetërore të brendshme për të bërë të mundur zbatimin e menjëhershëm dhe të përshtatshëm të KEDNJ-së,¹ e ka bërë të ditur qëndrimin e tij, që në seancën e datës 11.3.2024, ku, ndër të tjera, është shprehur dakord me kërkesën e znj. Sevdari për rishikimin e vendimit, duke vlerësuar dhe parashtruar se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së kërkesës për rishikim të znj. Sevdari, *ato lidhen me shqyrtimin në fakt të të njëjtës çështje gjyqësore të shqyrtuar më parë dhe marrë një vendim nga Kolegji.*

¹ Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së, për palët kontraktuese, përcaktohet në nenin 1 dhe 46 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 1 parashikon detyrimin e palëve kontraktuese për t'i siguruar çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e kësaj Konvente, të ratifikuar dhe nga Republika e Shqipërisë. Neni 46 i KEDNJ-së parashikon forcën detyruese dhe ekzekutimin e vendimeve, duke parashikuar se palët kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë. Kushtetuta, në nenin 122 të saj, ndër të tjera, parashikon statusin e posaçëm të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në rendin e brendshëm [...] 1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës.

Duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, ku referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, funksionon si kolegji i Gjykatës Kushtetuese, të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit, përmes procesit gjyqësor në Kolegji, i cili, dhe në rastin konkret, bazuar në kompetencat e saj kushtetuese, garanton zbatimin dhe implementimin e vendimit të GJEDNJ-së, në përputhje me legjislacionin dhe jurisprudencën vendase.

Komisioneri Publik ka theksuar se rishikimi i çështjes në rastin konkret ka të bëjë me faktin se *GJEDNJ ka gjetur shkelje të konventës europiane, “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të protokollove të saj, sipas nenit 494, germa “ë”, të K. Pr. civile”, duke u shprehur, ndër të tjera, në vendim, se në rrethanat specifike të çështjes së kërkueses, shkarkimi nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura.*

Në këto rrethana, Komisioneri Publik, në analizë të vendimit të GJEDNJ-së, ka vlerësuar se kemi të bëjnë me kundërshtimin e *përmbajtjes së vendimit nr. 6/2019 të Kolegjit, me përmbajtjen e një vendimi tjetër, atë të GJEDNJ-së, dhe, duke qenë koherent në qëndrimin e tij në raport me shkaqet e ankimit, është shprehur se për rastin konkret, nuk konstatohet ndonjë element i rëndësishëm që përbën shkak për rishikim analitik të ndryshëm të këtyre shkaqeve të ankimit, të parë në raport me ndonjë rrethanë të re të zbuluar rishtazi, siç parashikohet në nenin 494, germa “a”, të K. Pr. Civile.*

Në vendimin e saj, GJEDNJ nuk ka cenuar shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, përkundrazi, ashtu sikurse referuar dhe në parashtrimet e seancës së datës 17.4.2024, ndër të tjera, ka arsyetuar se të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të konstatuara nga KPA-ja kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se, në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj.

Po ashtu, lidhur me shkaqet e ankimit mbi vlerësimin e aftësive profesionale, ndër të tjera, ka arsyetuar se, *gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata i referohet opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, se apelimi konkret do të duhej të dorëzohej, duke pasur në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për paraqitjen e apelimeve të Prokurorisë, por ky apelim nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për të pasur sukses.*

Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, duke u bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit. Komisioneri Publik vendos në vëmendje që shkaqet konkrete, të paraqitura në ankimin e datës 29.8.2018, mbeten të tilla dhe pas administrimit të vendimit të GJEDNJ-së, të cilat, si në çdo ankim të paraqitur nga Komisioneri Publik, vlerësohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Çdo qasje tjetër e Komisionerit Publik, në rrethanat kur vendimi i GJEDNJ-së nuk rrëzon shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, por kërkon të vlerësohet proporcionaliteti i masës së shkarkimit, rrjedhojë e vlerës provuese të tyre në raport me kërkesat ligjore, nuk do ishte në përputhje me ligjin nr. 84/2016, i cili, ashtu sikurse Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij, përcakton *diskrecionin e Komisionit [dhe Kolegjit] “[...] të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]” dhe që ta bazojnë*

vendimin e tyre "[...] vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]"² Ky diskrecion ligjor i gjykatave, në vlerësimin e provave, është në përputhje të plotë edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së.³

Në rrethanat konkrete, aktet në dosje, paraqesin të njëjtat rrethana dhe fakte të paraqitura në ankimin e Komisionerit Publik, të cilat, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit dhe detyrat e tij funksionale, Komisioneri Publik ia ka nënshtruar dhe ia nënshtron juridiksionit kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në përfundim të sa më sipër, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të paraqitura në parashtrimet e datës 17.4.2024, çmon se në rastin e procesit të rivlerësimit të kërkuases, znj. Sevdari, mbetet e paprovuar e kundërta e barrës së provës, për sa në vijim:

A. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë

1. *Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, të deklaruar nga emigracioni, për krijimin e shtëpi banimi (4 kate).* Në aktet në dosje, ashtu sikurse dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje në Kolegj, subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues, duke mbetur të ardhurat e deklaruar me burim emigracionin, për efekt të kontrollit gjatë procesit të rivlerësimit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, në nivel deklarativ.

1.1 Në kuadër të qëndrimeve të konsoliduara të Kolegjit lidhur me këtë çështje⁴, të ardhurat e pretenduara nga kërkuësja, me burim emigracionin e bashkëshortit në Greqi, nuk provohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar *niveli i këtyre të ardhurave, fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, si dhe dërgesa e tyre nga vendi i origjinës në Shqipëri, në periudhën e deklaruar*. Konsiderimi i remitancave nga emigracioni si të ardhura që nuk rrjedhin nga një burim i ligjshëm, nëse për to nuk arrihet të vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore, është një qëndrim i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit.

2. *Për burimin e ligjshëm të shumës 12.000 euro nga emigracioni.* Referuar akteve në dosje, lidhur me burimin e shumës 12.000 euro, të deklaruar dhe pretenduar vetëm gjatë hetimit administrativ, në aktet në dosje, konstatohet se subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën vjetore të vitit 2003, nuk ka një kontratë pune ku të identifikohen marrëdhëniet me punëdhënësin dhe pagesa e pretenduar, nuk gjendet asnjë e dhënë mbi mënyrën se si është kryer kjo pagesë dhe nëse për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore për t'i konsideruar ato si atë ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.⁵

2.1 Kolegji, bazuar në pikën 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës⁶, në jurisprudencën e tij, ka arsyetuar se, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere, që: (i) janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas

² Neni 49, pika 4, fjalia e dytë e ligjit nr. 84/2016.

³ Referohuni arsyetimit të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 8/2021, prg. 19.1.

⁴ Shihni, ndër të tjera, vendimin nr. 4/2019, paragrafi 37.2.2.; vendimin nr. 23/2020, paragrafi 26.3; vendimin 14/2021, prg. 44; vendimin nr. 22/2021, paragrafi 27.4; vendimin nr. 3/2023, paragrafi 23.7.3 etj., të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁵ Po ashtu konstatohet se, për periudhën 2000-2003, në të cilën subjekti deklaroi se ka shpenzuar rreth 3.000.000 lekë, për krijimin e 1/3 të pasurisë, dhe 3.000 deri në 4.000 euro për mobilim, të ardhurat e ligjshme nuk mbulojnë këto shpenzime të deklaruar. Të ardhurat e ligjshme në këtë periudhë, të vërtetuara me dokumentacion ligjor provues, rezultojnë në shumën 1.869.447 lekë.

⁶ [...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...].

legjislacionit në fuqi, duke arritur në konkluzionin që në analizë duhet të përfshihen vetëm të ardhurat që plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

2.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, kërkuesja nuk arriti të provonte të kundërtën e këtij shkakut të ankimit, duke mbetur në konsideratë se, për këtë pasuri, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

3. Për të ardhurat nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, në Arabinë Saudite, në shumën 18.970 USD, deklaruar në deklaratën vjetore për vitin 2006

3.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe në rastin konkret, të ardhurat e deklaruara nga kërkuesja nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, rrethanë e cila mbetet e dëshmuar nga aktet në dosje dhe pas administrimit të vendimit të GJEDNJ-së.

3.2 Vetëm fakti që në llogarinë bankare të kërkueses (në USD) ka kaluar në total shuma prej 19.975,23 USD, nuk është kusht i mjaftueshëm për të legalizuar këtë vlerë si të ardhur të ligjshme në kuptim të dispozitave të mësipërme dhe të praktikës tashmë të konsoliduar të Kolegjit⁷.

3.3 Nga aktet në dosje, nuk u provua dhe nuk u dokumentua punësimi i pretenduar i bashkëshortit, kontrata e punës, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë mënyrën apo formën e marrjes së pagës, cilës palë i përket detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat dhe masa e detyrimit tatimor të paguar.

3.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar një pjesë të pasurive të saj, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

B. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

4. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, humbja e afatit të ankimit kundër vendimit nr. ***, datë **.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***, ***”, si dhe pohimi nga ana e subjektit të rivlerësimit se, deri në momentin e mospranimit nga Gjykata të kërkesës për rivendosje në afat, nuk e njihje mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të rastit faktor, provon se, për rastin në fjalë, kërkuesja ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe atyre organizative.

4.1 Komisioneri Publik vlerëson se, edhe në konsideratë të pretendimit të kërkueses, se mund të ketë qenë në kushtet e pamundësisë për të ushtruar personalisht të drejtën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës brenda afatit ligjor, për sa kohë e konsideroi të padrejtë atë vendim, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të njoftuar organin e Prokurorisë për këtë pamundësi, pasi ky organ, për shkak të organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tij, i kishte të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore që të mos e humbiste të drejtën e ankimit, por të mund ta ushtronte atë nëpërmjet një prokurori tjetër. Komisioneri Publik, ashtu si dhe GJEDNJ,

⁷ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 23/2020 (JR), paragrafi 25.4; nr. 35/2021 (JR), paragrafi 18.6.

vlërëson rëndësinë që paraqet ndjekja penale e veprave me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë, me ndikim në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë⁸.

4.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik arsyeton se, në rastin konkret, kërkuesja ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe si i tillë duhet vlerësuar, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Kërkimi i ankimit

- Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në nenet C, Ç, D, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016;
- Dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:
- *Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të kërkueses, znj. Antoneta Sevdari.*

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

⁸ Të gjitha përpjekjet e mëpasshme të znj. Sevdari, për të riparuar pasojat e humbjes së afatit të ankimit, kanë rezultuar se janë vlerësuar nga Gjykata të papranueshme dhe, për pasojë, është rrëzuar dhe kërkesa e paraqitur prej saj për rivendosje në afat, me arsyetimin se subjekti nuk ndodhej në kushtet e rastit faktor.